



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT

Nr. 818/2 prot

Date 28/06/2023

Lënda: Dërgim përgjigje për rishikimin e Oponencës Teknike të akt ekspertizës së thelluar

BASHKISË DURRËS

Durrës

Në bazë të kërkesës suaj me Nr. 6429/1 Prot, date.28.05.2024, protokolluar me tonën me Nr.818 Prot, datë. 31.05.2024, “Kërkesë për rishikimin e oponencës teknike të akt ekspertizës së thelluar”, Bazuar në Nenin 34, të Aktit Normativ Nr.9, datë.16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, po ju dërgojmë në 2 kopje, oponencën teknike të objektit: “Pallati Nr.15, Rruga “Abaz Celkupa”, GIS 24795, Bashkia Durrës.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Artan SHKRELI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT

OPONENCË TEKNIKE
MBI RISHIKIMIN E OPONENCËS TEKNIKE TË AKT EKSPERTIZËS SË
THELLUAR TË OBJEKTIT:
“PALLATI NR.15, RRUGA “ABAZ CELKUPA”, GIS 24795, BASHKIA
DURRËS

POROSITËS: BASHKIA DURRËS

PROJEKTUES : SHOQËRIA: “ARKONSTUDIO ” SH.P.K.

GRUPI I PROJEKTIMIT

- Ing. Dhimitër PAPA

Nr. Liç. K.1510/2

Bëhet kjo oponence teknike mbi rishikimin e oponencës teknike të akt ekspertizën e thelluar të objektit: “Pallati Nr.15, Rruga “Abaz Celkupa”, GIS 24795, Bashkia Durrës, Bazuar në Nenin 34, të Aktit Normativ Nr.9, datë.16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

Materialet e paraqitura për hartimin e oponencës teknike janë:

- Kërkesa për kryerjen e Oponencës Teknike e Bashkise Durrës me Nr.6422/1 Prot, date. 28.05.2024, protokolluar me tonen me Nr. Prot.818 , Datë .31.05.2024.
- Marrëveshja ndërmjet Institutit të Ndërtimit dhe Bashkisw Durrws me Nr. 818/1 Prot, te IN-së, ku tarifa e rishikimit të oponencës teknike për këtë objekt është **50,000** (pesëdhjetë mijë) lekë me TVSH .
- Preventivi i ndryshuar
- Relacion teknik sqarues

1. TË PËRGJITHSHME

Struktura e objektit “Pallati Nr. 15, Rruga Abaz Celkupa” është konceptuar dhe realizuar me konstruksion mbajtes me rama beton arme (EC8 Frame System), ku ngarkesa sizmike perballohet kryesisht nga kolonat. Objekti i jep prioritet te dy drejtimeve perpendikulare per garantimin e zhvendosjeve te lejuara nga veprimet e ngarkesave te jashme, kryesisht atyre sizmike. Elementet konstruktive duhet te jene llogaritur dhe dimensionuar nen veprimin e ngarkesave maksimale te mundshme sipas kombinimit te ngarkesave. Strukturat horizontale perfaqesohen nga elemente beton arme, soleta beton arme me traveta me trashesi 25 cm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT

Themeli: është realizuar me pllake masive b/a te perforcuar me trare te thelle te mbeshetur mbi tufen me pilota, sikurse tregohet ne projektin ekzistues te objektit fillestar te vendosur ne dispozicion nga Bashkia Durres dhe projektuesi konstruktor ing. Agim Koci. Pllaka është e projektuar dhe realizuar me trashesi $t=75$ cm, e perforcuar me trare te thelle me seksion te prerjes terthore "T" te permbytur me permasa $150 \times 125 / 60 \times 335$ cm. Pilotat jane me diameter $D=50$ cm dhe gjatesi 9.5 ml deri ne 12.75 ml ne pjesen perimetrale te objektit. Pllaka e themelit është e vendosur mbi nje paket shtresash inerte me trashesi totale $t=40$ cm te perber nga nje shtrese betoni M-100 me trashesi $t=20$ cm dhe nje shtrese zhavorri e ngjeshur me $t=20$ cm. Thellesia e zhytjes se pllakes se themeleve shkon deri ne kuoten -4.50 m referuar kuotes 0.00.

Objekti ka siperfaqe te katit perdhe rreth 440 m^2 , dhe te katit tip rreth 530 m^2 . Lartesi e katit perdhe 3.96 m dhe katit tip 3.06 m. Destinacioni kryesor është ai i banimit por ka dhe ambiente sherbimi ne katin perdhe. Objekti ka nje siperfaqe te pergjithshme rreth 6450 m^2 .

Në oponencën e mëparshme të kryer nga Institutit i Ndërtimit për këtë objekt ka rezultuar që ky objekt duhet të përforcohet dhe të rikonstruktohet me një vlerë të punimeve të rikonstruksionit prej **41,831,881 lekë pa tvsh**. Vlerësimi sipas sipërfaqes ekzistuese në përqindje dhe cmimeve për m^2 të Entit të Banesave ka rezultuar me e vogël se 70%.

Vlera e re e punimeve të rikonstruksionit është **81,831,881 lekë pa tvsh**.

Sipas relacionit shpjegues që shoqëron materialin autori Ing. Dhimiter Papa, thekson se Rishikimi i preventivit konsiston në rritjen e volumeve të përforcimit dhe të rifiniturës pasi nga inspektimi në terren dhe ballafaqimi me projektin e përforcimit të këtij pallati u vërejt që realizimi i punimeve sipas projektit kërkon volume shtesë, ndërsa modeli llogaritës dhe projekti i përforcimit mbeten të pandryshueshëm.

Projekti i përforcimit konsistonte në përforcimin e elementëve strukturore si me poshte.

- Shtimi i mureve beton arme me trashesi 30 cm,
- Shtimi i mureve beton arme me trashesi 30 cm ne kafazin e shkalleve dhe ashensorit
- Kemishim i disa prej kollonave

Për ndryshimet ne preventiv nuk është paraqitur projekt i ri.

2. PREVENTIVI I RISHIKUAR

Preventivi i ripunuar jepet në 3 faqe format A4, hartuar nga projektuesi dhe firmosur nga Ing. Dhimiter Papa.

Vlera e re e punimeve të përforcimit është **81,831,881 leke pa TVSH**, e cila duke e krahasuar me vlerën totale të ndërtimit të objektit nga e para $6450 \text{ m}^2 * 32,105 \text{ lekë/m}^2 = 207,077,250 \text{ lekë me tvsh}$ ose **172,564,375 leke pa tvsh**, duke iu referuar kostove ndërtimore në treg për një sipërfaqe të njëjtë është 47.42 % më e vogël se 70%, ($47.42 \% < 70\%$).

Cmimet ne preventiv në përgjithësi janë paraqitur sipas VKM Nr.629 , date.15.07.2015.

Për zërat që janë shënuar An (analizë) nuk janë paraqitur analizat e detajuara të cmimeve. Të plotësohen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT

Rekomandojmë që cmimet në preventiv të merren sipas VKM Nr.213, datë 13.04.2023, në fuqi në vendin tone.

Cdo volum shtesë që është bërë në preventiv duhet të shoqërohet me projektin dhe detajet për këto punime shtesë.

PËRFUNDIM:

Si përfundim mund të themi se nga shqyrtimi i materialit të objektit: "PALLATI NR.15, RRUGA "ABAZ CELKUPA", GIS 24795, BASHKIA DURRËS, ka rezultuar se: edhe me vlerën e re të preventivit të paraqitur, ky objekt duhet të përforcohet dhe të rikonstruktohet. Cdo ndryshim në volume në preventiv duhet të bëhet, duke u pasqyruar dhe në projekt.

Punoi :

Ing.Valbona PONDE

DREJTORE DREJTORIE

